

**VENDIM**  
**Nr. 79, datë 8.6.2015**

**PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**  
**NGA SHOQËRIA "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SHA TEK SHOQËRIA "HEC**  
**LANABREGAS" SHA**

Në mbështetje të neneve 9; 19 dhe 20, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 17, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", Bordi i Komisionerëve i ERE-s në mbledhjen e datës 8.6.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë" sh.a., licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 99, datë 13.9.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë "Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë" sh.a., për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1 (neni 17, pika 4, germa "a") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Informacioni me shkrim, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës (neni 17, pika 4, germa "b") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës (neni 17, pika 4, germa "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

2. Aplikimi i shoqërisë "HEC Lanabregas" sh.a., për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të transferojë licencën e tregtimit të energjisë elektrike nr. 147, seria TPV11SH miratuar me vendimin nr. 99, datë 13.9.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nga shoqërisë "Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë" sh.a., te shoqëria "HEC Lanabregas" sh.a..

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqëria "Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë" sh.a. dhe "HEC Lanabregas" sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**